



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 39-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.02.2025, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Gazmend Qerkini, anëtar
3. Shkelzim Olluri, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Nexhemdin Lekiqi, anëtar
6. Fadil Sopa, anëtar
7. Sami Bytyqi, anëtar
8. Fitim Shala, anëtar
9. Xhyzide Rrustemi, anëtare
10. Rinor Murati, anëtar
11. Armend Grajqevci, anëtar
12. Gentianë Hoxhaj, anëtare
13. Venhar Agushi, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rrustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
21. Ganimete Qeriqi, anëtare
22. Alban Salihu, anëtar
23. Fitim Meziu, anëtar
24. Fatmir Fetahu, anëtar
25. Shahadije Dragaçina, anëtare
26. Besiana Sylja, anëtare
27. Enver Kryeziu, anëtar
28. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i komunës
4. Latif Ramadani, DBF
5. Shkelzen Hajdini, DSHMS
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Valon Pacolli, DEZH
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DKA
11. Safete Amerllahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPMSh
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Emine Mustafa**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 38-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.
3. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni në Sllovi.
4. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës-lokaleve afariste në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.
Ashtu siç ju kemi njoftuar edhe me herët me propozim të ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së, kemi edhe një pike shtesë, të cilën e keni marrë dje.
6. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës së propozuar, me një pikë shtesë dhe pas votimit u konstatua se me 28 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Albiona Tasholli, tha se së pari ua uroj muajin e shenjtë të Ramazanit të gjithëve. Kam disa pyetje e para ka të bëjë me zjarrin e shkaktuar te shtigjet e ecjes në Gadime a ka marr komuna ndonjë informacion nga policia lidhur me ndezjen e këtyre zjarreve, nëse po. Cilët janë faktorët që është shkaktuar. Pas shkaktimit të këtij zjarri janë shkaktuar dëme të mëdha. Kërkoj nga drejtoria përkatëse të marr iniciativën për pastrimin e hapësirave rreth trotuareve, të drunjëve të djegur dhe thyer të cilat po dëmtojnë pamjen e përgjithshme dhe janë shndërruar në mbetje të pa nevojshme. Ju bëjë thirrje qytetarëve që ti ruajnë pasurinë publike. Kërkoj nga drejtoria përkatëse që të bëjë vendosjen e një pasqyre rrugore në rrugën “Shpella e Mermerit” përballë Viva Freshit pasi që aty po ka problem. DKA-ja, meriton falënderim për ndarjen e bursave, Ka pyetje nga disa studentë kur do te ekzekutohen pagesat e bursave.

Arsim Jashari, tha se edhe unë në emër të grupit të PDK-së, ua urojë muajin e Ramazanit të gjithë qytetarëve. Pastaj tha se kam disa pyetje dhe kërkesa, e para ka të bëjë me shpenzimet mujore të parkingut nëntokësor dhe të nënkalimit, sa janë shpenzimet për mirëmbajtje energji dhe kostot tjera, kërkoj një pasqyre te saktë pasi që qytetarët duhet të informohen. E dyta rreziku nga kulmi i shkollës së vogël në fshatin Banullë, pasi po rrezikohen fëmijët, duhet të ndërmerren masa që të ndalohet hyrja e fëmijëve në atë vend. Këshilli i fshatit Banulle përmes kryetarit të fshatit Afrim Hajrullahu ka dërguar një shkresë lidhur me këtë çështje dhe duhet të ndërmerren masa. Pse është ndërprerë projekti për vendosjen e mbrojtësve të urave në fshatra, mjetet janë ndarë mirëpo projekti nuk po vazhdon kërkoj një sqarim. Prona e ndarë për mbeturina ne fshatin Topliqan dhe shqetësimi i qytetarëve, ku kjo pronë është ndarë pa miratimin e këtyre qytetarëve të lokalitetit përkatës gjë që ka shkaktuar probleme të mëdha. Kompania përgjegjëse nuk ka bërë ende asnjë investim për përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse. Qytetarët kanë përgatitur një petition për këtë çështje kërkojmë një sqarim nga ana juaj. Çka po ndodh me emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve nëpër fshatra, deri ku keni arritur a e keni bërë ndarjen që kemi kërkuar dhe deri ku ka shkuar procesi.

Rinor Murtai, tha se kam disa çështje për ti adresuar, e para sa i përket pozicionimit të taksive te dalja e nënkalimit, nga kontakti me qytetar po shkakton rrezik edhe për këmbësoret, a është diskutuar çështja e pozicionimit të tyre-zhvendosja nga ai vend. Çështja tjetër ka të bëjë me ndriçim publik, sa i përket mirëmbajtjes e kam adresuar edhe disa herë këtë çështje, a ka ndonjë informatë sa i përket ndriçimit publik a keni ndonjë njoftim nga OSHP-ja, për këtë çështje. Disa qytete po e praktikojnë dekorimin në lagjet ku ka xhami, në muajin e Ramazanit, do të ishte mirë që diçka e tillë të planifikohej edhe te ne.

Ganimete Qeriqi, tha se unë në 17 vjetorin e Pavarësisë isha në vizitë në Laç në Shqipëri, dhe isha shume e kënaqur se si kremtohet festa e Pavarësisë se Kosovës. Pas kremtes u diskutua për binjakëzimin me komunën e Lipjanit. Desha me pyet se a kemi ndonjë binjakëzim me ndonjë komunë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se para disa mbledhjeve e kam ngrit çështjen e rrugicës që e lidhë rrugën “Zylfije Gashi” me rrugën “Isa Olluri” pas punimeve që ka bërë kompania Xhema është demoluar ajo rrugice, dhe prej asaj kohe ajo rrugice është në gjendje të mjerueshme. Par disa dite janë publikuar listat e përfituesve të bursave për studentë, pyetja ime pse janë në liste vetëm 323 a nuk ka pas interesim të studentëve për të aplikuar apo nuk i kanë përmbushur kriteret. Këto dite jemi alarmuar nga vdekja e një gruaje në Podujevë nga qentë endacak, edhe në Lipjan është një rrezik i madh nga qentë endacak për qytetarët.

Egzona Bytyqi, tha se së pari e kam një vërejtje për kryesuesin pse nuk është mbajt mbledhje solemne për ditën e Pavarësisë 17 shkurtin. Pasi për mua kjo datë është e rëndësishme sepse ngërthen gjak, sakrificë, mund nëse i referohemi historisë më të re të popullit tonë. Tjetra do të ndalem te parku i biznesit në Qylagë cila është dinamika e zhvillimit aty, pasi që kemi parë që disa lëvizje pozitive në atë pjesë janë. Rruga që të dërgon te parku nacional është kompletuar, a funksionojnë dritat me konsum të ulët energjetik. Po ashtu është nënshkruar një petition për kundërshtimin e një deponie në atë pjese a ka ndonjë njoftim nga niveli qendror.

Lulzim Rrustemi, tha se sa kemi dal nga fushata zgjedhore i falënderoj të gjithë qytetarët për maturi të treguar gjate kësaj kohe. Ku ka qenë një fushatë e mirë demokratike e qetë. Kam disa pyetje, e para a ka filluar procedura për ndërtimin e urës mbi lumin Sitnica a ka gjasa që sivjet të fillon ndërtimi i asaj ure. E dyta te rruga “Lidhja e Prizrenit” ndërtesa te lokali i chekinit, çfarë statusi ka ajo ndërtesë. A është shpronësuar, në cilat fazë është dhe deri ku ka shkuar. Pyetja e 3-të, për bursa ka dalë lista preliminare prej 323, një informatë nga DKA-ja, pse kaq i vogël numri kur ne i kemi nda 400 bursa, as s’ka pas interesim a si kanë plotësuar kriteret.

Alban Salihu, tha se disa nga çështjet u ngritën nga parafolësit por nuk teprohet nëse i përsërisim. Afër 10 vite po bëhen që kanë filluar punimet në zonën ekonomike në fshatin Qylagë deshta me ditë ku janë procedurat dhe a ka ndonjë afat të funksionalizohet kjo zonë pasi që investimet kanë qenë të mëdha. Po ashtu ka pas reagime edhe neve na kanë kërkuar me reaguar banoret e fshatit Topliqan rreth deponisë që ka shkaktuar probleme, ju si komunë a jeni takuar me banorët e asaj pjese, me gjet ndonjë zgjidhje. Tjetra, te dalja e nënkalimit po është një zonë e rrezikshme

për mos me u shkaktuar probleme në komunikacion kërkoj nga ana juaj të bëhet një zgjidhje.

Shahadije Dragaçina, tha se dje e kemi mbajt mbledhjen e komitetit për komunitete dhe drejtori i bujqësisë na dha informatë që ka filluar zhavorrimi i rrugëve bujqësore diku 12 klm, cilat fshatra kanë përfituar, zhavorrim të rrugëve dhe cilat fshatra do të zhavorrohen. Tjetra një konkurs është hap në ZLK , në konkurs nuk është si kriter njohja e një gjuhe të huaj. Është mirë që kur të hapen konkurset si kriter të jetë edhe gjuha e huaj, pse nuk është si kriter gjuha e huaj.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se zjarri ne Gadime ka qenë një fatkeqësi e madhe për qytetarët e komunës tonë, efekti njeri ka qenë shkaktar i atyre zjarreve sipas policisë. Ne si institucion kemi reaguar disa herë që të ketë kujdes ndaj investimeve publike. Sa i përket bursave e kemi zgjat konkursin për shkak të festave zyrtare, ne e kemi shpallë për 400 bursa konkursin, ndërsa i kanë plotësuar kriteret vetëm 323 studentë. Për studentet që studiojnë jashtë vendit do të subvencionohen me kërkesë direkt nga zyra Kryetarit. Sa i përket nënkalimit dhe parkingut është funksional përveç shpenzimeve të rrymës nuk kemi ndonjë shpenzim tjetër aty. E kemi shpallë një kontratë për menaxhimin por e kemi në OSHP. Sa i përket rrezikut të kulmit të shkollës së Banullës, do të merren masat e nevojshme. Nuk kemi kontratë të ndërpre për mbrojtës të urave. Në Topliqan ka pas një shqetësim të banorëve, ne si komunë i kemi marr masat, por kompania Pastrimi nuk menaxhohet nga komuna. Komisioni për emërimin e rrugëve ka bërë një punë të mirë , dhe janë drejt finalizimit. Lokacioni i taksive jo fort i përshtatshëm, shumë shpejt do të largohen nga ai lokacion. Kemi binjakëzim me disa komuna në Shqipëri. Sa i përket qenve endacak qe 3 herë jemi tu e shpallë kontratën mirëpo ka dështuar. Është një shqetësim i madh për të gjithë. Është shpallë kontrata presim që të bëjmë një zgjidhje. Rrugica në mes të rrugës “Zylfie Gashi” dhe “Isa Olluri” do të asfaltohet shpejtë. Zona ekonomike është duke shkuar shumë mirë, dhe pritet që 4 biznese të fillojnë punën. Pritet të kompletohet shumë shpejtë si zonë. Ura e Rucit është kthyer prej OSHP-së, shume shpejt pritet të filloj. Zhavorrimi i rrugëve bujqësorë është bërë nga drejtorja e bujqësisë dhe drejtori i ka të gjitha statistikat. Gjuhë zyrtare është gjuha shqipe dhe serbe dhe atë e kemi në konkursë.

Arsim Jashari, tha se mjetet janë ndarë për vendosje të mbrojtësve të urave, në fshatin Banullë nuk është vendosur asnjë mbrojtëse. Sa i përket emërtimit dhe riemërtimit unë pata kërkuar të ndahen pasi që kanë problem mes vete. Dhe sot ende nuk ka zgjidhje.

Shahadije Dragaçina, tha se sa i përket konkursit në ZLK, a ka pas të interesuar edhe nga komunitetet për tu punësuar.

Egzona Bytyqi, tha se me sa po e shoh unë iniciativat dhe kundërshtimet tona institucionale që i kemi marr bazuar në legjislacion për deponinë si duket as nuk paskan ra në sy as në vesh të Qeverisë. Unë propozoj me kaluar në planin B sepse nuk jemi në zonën e komoditetit me pritë.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se sa kemi pas një kontratë për rregullim të urave , por jo për mbrojtëse të urave. Sa i përket konkursit bëje një kërkesë te zyra personelit dhe merrni përgjigje. Sa i përket Qeverisë nuk kemi marr asnjë përgjigje nga ana e tyre rreth deponisë në Topliqan por po presim reagimin qytetarë shumica e fshatrave rreth këtij lokaliteti po përgatisin peticione për ta kundërshtuar këtë. Dhe ne do ta kundërshtojmë dhe nuk do të lejojmë që ajo deponi të ndërtohet aty.

Nexhmedin Lekiqi, tha si anëtar i komisionit për emërtimin e rrugëve, nga fillimi kemi pas pengesa, emërtim, rriemërtim. Në këtë fazë janë përfunduar vetëm rrugët të pa emërtuara, apo rrugëve të reja.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 38-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth ekstraktit nga mbledhja e 38-të e Kuvendit.

Meqë nuk pati vërejte as plotësime Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 38-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 30 vota për , aprovoi Ekstraktin .

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi , Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHMS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj, tha shumë mirë që ka ardhë ky propozim nga ana e ekzekutivit, konsiderojmë që është shumë i nevojshëm ky propozim vendim dhe në emër të grupit të LDK-së, e mbështesim këtë propozim.

Arsim Jashari, tha se në si grup i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim, por kam një kërkesë që të themelohet një komision që këto familje të përcjellën sepse kam disa ankesa që ka prej tyre që ka përfituar banesë dhe ka shtëpi në fshat është mirë me i përcjell këto raste.

Alban Salihu, tha se e shohim si të nevojshëm këtë propozim vendim dhe në emër të grupit e mbështesim.

Lulzim Rrustemi, tha se duke parë gjendjen ekonomike dhe zhvillimin që e kanë qytetaret, natyrisht që duhet me ju ndihmuar dhe me vazhduar këtë ndihmë. Por duhet me pas një komision me vlerësuar cili është progresi i atyre familjeve a ka lëvizje. Dhe me ju dhënë mundësi edhe te tjerëve.

Shkelzen Hajdini, tha do ta kemi në konsideratë propozimin për formim të komisionit se basku me zyrën pronësore.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, , aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni në Slllovi.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemi, drejtor i DSHPMM i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Xhyzide Rrustemi, tha se e mbështesim këtë propozim vendim në emër të grupit të LDK-së.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha edhe në si grup i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim uroj që të zgjidhet problemi i energjisë elektrike në Slllovi.

Alban Salihu, tha se uroj të shtohen kërkesa të tilla për shkak sepse shumë fshatra po e kanë problemin e njejt, me energji të dobët elektrike, në si grup e mbështesim këtë propozim vendim.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli, drejtor i DEZH i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha ne si grup i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim, por e kam një pyetje brenda hartave zonale a kena mundësi me pas fleksibilitet me ulë çmimin, ndoshta e merr dikush.

Valon Pacolli, tha se çmimi fillestar mirret vendimi ne kuvend. Na e kemi lan një çmim fillestar 1.50 euro, m2.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, dhe 5 abstenim, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës-lokaleve afariste në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor i DBF i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj, tha se ne emër te grupit të LDK-së, e propozojmë Fitim Shalën.

Herolind Kozhani, tha se në emër të grupit të PDK-së, e propozojmë Lulzim Rrustemi.

Lulzim Rrustemi, tha se te neni 6 duhet të ceket cili ligj, sepse në të kaluarën ka qenë në vlerën e komiteteve obligative.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se nuk po kemi problem vetëm me komisione për pagesa po kemi edhe me komitete pengesa për pagesë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për,5 abstenim, aprovoi propozimin.

VI

Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha sa përfitues do të jenë në këtë listë që do të përfitojnë.

Alban Salihu, tha se e mbështesim këtë propozim por kërkojmë që komuna me qenë sa më transparente.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne e përkrahim çdo iniciativë sidomos për gratë e marginalizuara , por kam një kërkesë që të jetë shpërndarja në mënyrë meritore.

Gentianë Hoxhaj, tha se në emër të grupit të LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim.

Rexhep Rexhepi, tha se përfitues do të jenë mbi 45 fermerë. Ne kemi në komision një anëtar ndërsa tjerët janë nga organizata dhe besoj që ka transparencë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:30.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi